

UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT A1Z
Matura Shtetërore 2016

1. **Formulari A1Z** plotësohet online. Procedura e plotësimit do të bëhet sipas një udhëzimi të veçantë.
2. Formulari A1Z plotësohet nga:
 - a) Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme para vitit 2016 dhe që kanë detyrim për të dhënë një ose disa provime të Maturës Shtetërore;
 - b) Kandidatët që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë vendit dhe, pasi kanë bërë njehsimin e diplomës në komisionin përkatës të MAS, rezultojnë se kanë detyrim për të dhënë një ose disa provime të Maturës Shtetërore.
3. Procesi i plotësimit të **Formularit A1Z** ndiqet nga një person i ngarkuar nga drejtoria e shkollës, që do të quhet “mbikëqyrës”.
4. Mbikëqyrësi pajiset me kodin përkatës të hyrjes në sistem. Vetëm pasi mbikëqyrësi fut kodin në sistem, kandidati mund të përfundojë plotësimin e **Formularit A1Z**.
5. Kandidatët për të plotësuar formularin A1Z, duhet të paraqesin tek mbikëqyrësi një vërtetim të lëshuar nga shkolla ku ka dhënë provimet. Vërtetimi, veç gjeneraliteteve duhet të ketë edhe këto të dhëna:
 - a) Provimet e detyruara dhe vlerësimet e shkallëzuara të secilit provim, nëse ato rezultojnë të fituara nga kandidati.
 - b) Provimet me zgjedhje dhe vlerësimet e shkallëzuara të secilit provim, nëse ato rezultojnë të fituara nga kandidati.Vërtetimi pas përfundimit të aplikimit i bashkëngjitet kopjes së formularit A1Z, që mban shkolla dhe dorëzohet në AKP 5 ditë pas përfundimit të aplikimeve.
6. Plotësimi i Formularit A1Z fillon në Portalin Qeveritar dhe përfundon në shkollë.
7. Lista me të dhënat e marra nga plotësimi i formularëve printohet, nënshkruhet nga maturanti, mbikëqyrësi dhe vulozet nga drejtori i shkollës ku plotësohen formularët A1Z. Listat ruhen deri në përfundim të Maturës Shtetërore 2016.

I. Të dhënat personale

Plotësohen nga kandidati

- **Tek pika 1**, (numri personal i letërnjoftimit ID), kandidati shënon numrin e tij personal që ka në dokumentin e identifikimit.
Për të dhënat 2-5, pas plotësimit nga kandidati, sistemi bën verifikimin e tyre dhe nuk lejon të vazhdohet aplikimi, nëse ka pasaktësi.
- **Tek pika 6**, kandidati shënon në fushat përkatëse, numrin e telefonit dhe adresën e email-it, të cilat duhet të ruhen të pandryshuara deri në fund të Maturës Shtetërore 2016, me qëllim që ai (kandidati) të marrë informacion në faza të ndryshme të procesit.

Nëse kandidati nuk ka telefon, ose nuk dëshiron të shënojë numrin e telefonit, atëherë mbikqyrësi shënon numrin e tij të telefonit.

- **Tek pika 7**, kandidati zgjedh nga lista Po ose Jo.

II. Të dhëna shkollore

Të dhënat shkollore do të plotësohen në bashkëpunim me **mbikqyrësin** e sallës ku bëhet aplikimi. Për plotësimin saktë të kërkesave të këtij grupimi, kandidatët dhe mbikqyrësi duhet të marrin informacion të saktë dhe të plotë për rubrikat përkatëse:

Plotësohen nga kandidati

- **Tek pika 8**; (emri i qytetit/fshatit), kandidati shënon emrin e qytetit/fshatit ku ndodhet shkolla ku ai ka studjuar.
- **Tek pika 9**; (emri i shkollës ku ka studjuar), kandidati shënon emrin e shkollës ku ai ka studjuar.

Plotësohen nga mbikqyrësi

- **Tek pika 10**, mbikqytësi plotëson emrin e DAR/ZA-së përkatëse.
- **Tek pika 11**, (Indeksi i profilit), zgjidhet nga lista numri dyshifror që i përket shkollës ku ka studiuar kandidati ose ai që përcaktohet nga komisioni i njehsimit të diplomave për shtetasit që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, sipas listës së miratuar nga MAS.
- **Tek pika 12**, (emërtimi i profilit) mbikqyrësi plotëson emrin e profilit/degës.

III. Të dhëna lëndore

Plotësohen nga mbikqyrësi

Zgjedhja e lëndëve bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 1, datë 11.02.2016 dhe Udhëzimin nr. 6 datë 03.03.2016.

Të dhënat e mëposhtme mbikqyrësi i plotëson në mbështetje të vërtetimit të përmendur në pikën 3 të këtij udhëzimi:

- ID e kandidatit: Shënohet ID që kandidati ka marrë në maturat e mëparshme. Nëse nuk ka marrë ID, fusha të mbetet bosh.
- Viti i përfundimit të shkollës së mesme: (zgjidhet nga lista “Viti i përfundimit të shkollës së mesme”).
- Nëse ka marrë dëftesë pjekurie të shënojë **Po**, nëse nuk ka marrë dëftesë pjekurie të shënojë **Jo**.

Lëndët e detyruara

➤ Lëndët e detyruara që mbarten:

Lënda D1: Në këtë fushë shfaqet “Letërsi”. Mbikqyrësi plotëson notën e shkallëzuar të kësaj lënde, që i njihet apo i është konvertuar nga komisioni përkatës, si lëndë D1.

Lënda D2: Në këtë fushë shfaqet “Matematikë”. Mbikqyrësi plotëson notën e shkallëzuar të kësaj lënde, që i njihet apo i është konvertuar nga komisioni përkatës, si lëndë D2.

➤ Lëndët e detyruara që do zgjidhen:

Nëse kandidati mbart lëndën D1, ai do të japë provim vetëm D2, prandaj zgjidhet “Lënda D2”.
Nëse kandidati mbart lëndën D2, ai do të japë provim vetëm D1, prandaj zgjidhet “Lënda D1”.
Nëse kandidati mbart lëndët D1 dhe D2, nuk do të zgjidhet as “Lënda D1” e as “Lënda D2”.

- **Lëndët me zgjedhje:**

- Mbartja e lëndëve me zgjedhje:

Lënda Z1: Zgjedh nga lista lëndën Z1 që do të mbartë dhe shënon vitin kur e ka dhënë dhe notën e shkallëzuar të saj.

Lënda Z2: Zgjedh nga lista lëndën Z2 që do të mbartë dhe shënon vitin kur e ka dhënë dhe notën e shkallëzuar të saj.

Nëse lënda/lëndët e mbartura janë dhënë disa herë provim, do të mbartet nota e marrë në vitin e fundit.

- Zgjedhja e lëndëve me zgjedhje:

- a) Kandidati që mbart nga maturat e viteve 2006-2015 dy lëndë me zgjedhje, nuk do të japë provim me zgjedhje.
- b) Kandidati që mbart nga maturat e viteve 2006-2015 një lëndë me zgjedhje, duhet të zgjedhë për të dhënë provim vetëm një lëndë me zgjedhje, në përputhje me Udhëzimin Nr. 1, datë 11.02.2016 dhe Udhëzimin nr. 6 datë 03.03.2016.
- c) Kandidati që nuk ka mbartur lëndë me zgjedhje nga maturat para vitit 2016, duhet të zgjedhë për të dhënë provim dy lëndë, nga lista e lëndëve me zgjedhje, në përputhje me Udhëzimin Nr. 1, datë 11.02.2016 dhe Udhëzimin nr. 6 datë 03.03.2016. Lëndët e zgjedhura duhet të plotësojnë kushtin, jo më pak se 8 kredite.